

Aktivitetet për nder të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës

16 shkurt -20 shkurt 2018

Aktiviteti i planifikuar “Kremtimi i 10-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës” u realizua nga Qendra Kulturore e Kosovës në Zvicër, në bashkorganizim me Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih. Manifestimi u mbajt më 17 shkurt 2018 në prani të personaliteteve shtetërore të shërbimit diplomatik të Kosovës në Zvicër, përfaqësuesve të shtetit Zvicrës, përfaqësuesve të LAPSH-it, sportistëve shqiptarë me renome ndërkombëtare, Rrjetit të bizneseve, shoqatave kulturore, artistëve, bashkatdhetarëve dhe figurave të çmuara që jetojnë dhe veprojnë në Diasporë.

Në kremtimin jubilar të Pavarësisë së Kosovës ishin të pranishme edhe Shyhrete Gosalci, u.d. Sekretare e Përgjithshme, dhe Shyhrete Kastrati, drejtoreshë e Departamentit të Qendrave Kulturore në Diasporë.



Manifestimi filloi me intonimin e himnit kombëtar, për të vazhduar me një pikë muzikore, interpretuar nga violinistja Eliza Pintolli, dhe pika të tjera artistike.





Madhështia e manifestimit ishte performanca e Elina Duni & Rub Luft, e cila u paraqit me disa këngë shqipe, të përzgjedhura nga repertori i saj i pasur muzikor



Ky aktivitet ishte i rëndësishëm për faktin se u vunë kontakte të reja me bashkatdhetarë, qëllimi i të cilave ishte përfshirja e tyre në aktivitetet dhe projektet e planifikuara nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, kulturës, traditës dhe identitetit kombëtar në përgjithësi.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe u realizuan edhe takime për mundësitë që ofron shteti i Kosovës, përkatësisht Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Takime pati edhe në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Cyrih, me përfaqësuesit e së cilës u bisedua për tema me interes për bashkatdhetarët.